



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[eëë.avokatipopullit.gov.al](http://eëë.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202300233/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda:** *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të burgosurve në Institucionin e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale (IEVP) në Rrogozhinë.*

**Drejtuar:** Z. Admir ABRIJA  
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Kolë KUKAJ  
Drejtor i IEVP-së Rrogozhinë

RROGOZHINË

*Të nderuar zotërinj,*

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në neni 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si dhe neni 81 i ligjit 81/2020 "Për trajtimin dhe të drejtat e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", zhvilloi inspektimin periodik në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) në Rrogozhinë.

Inspektimi u krye në datë 28.02.2023 sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi i inspektimit drejtohej nga z.Ahmet Prençi, Komisioner i MKPT-së dhe në përbërje z.Besnik Deda dhe z.Hazbi Selita, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i vizitës inspektuese ishte vlerësimi i përgjithshëm i të drejtave të të burgosurve, të cilat ju garantohen me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve.

Gjatë inspektimit u verifikuan kushtet infrastrukturore që garantojnë sigurinë, jetesën, shëndetin dhe zhvillimin e aktiviteteve rekreative për të burgosurit, me qëllim

rehabilitimin dhe ri-integrimin e tyre; trajtimi dhe ofrimi i shërbimeve të të burgosurve në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore; kontrolli dhe administrimi i dokumentacionit që evidenton punën e kryer sipas secilit prej sektorëve mbështetës; si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm<sup>1</sup>.

Institucioni i Avokatit të Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrojë gjetjet e inspektimi dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.

### **Shënime të përgjithshme**

Vizita inspektuese e MKPT-së në IEVP Rrogozhinë për vitin 2022, u zhvillua në bazë të metodologjisë për inspektimin në burgje. Grupi i inspektimit zhvilloi paraprakisht një takim prezantues me drejtorin e institucionit z.Kole Kukaj dhe shefin e policisë z.Edmont Alimadhi, të cilët u njohën me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, drejtuesit e institucionit informuan në lidhje me masat e marra për garantimin e të drejtave dhe trajtimin e të dënuarve në këtë institucion, plotësimin e kushteve të jetesës në dhomat e banimit dhe ambientet e përbashkëta, aktivitetet që zhvillohen me të të dënuarit, si dhe për zbatimin e rekomandimeve të MKPT-së në inspektimin e mëparshëm.

Sipas informacionit, bazuar në Urdhërin nr. 8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë, “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, i ndryshuar, IEVP Rrogozhinë kategorizohet “*Burg i sigurisë së zakonshme*”.

Kapaciteti fizik i institucionit, bazuar në numrin e dhomave dhe kompletimit me shtretër, ka një kapacitet akomoduese për **343 persona të burgosur**. Në ditën e zhvillimit të inspektimit, në institucion ndodheshin **315 të dënuar** me vendime të formës së prerë të gjykatave, siguria e zakonshme.

Në lidhje me respektimin e kapacitetit fizik, grupi i inspektimit verifikoi situatën e popullimit në IEVP Rrogozhinë edhe për periudhën e fundit 6 mujore dhe nga informacioni rezultoi se, numri i të dënuarve të akomoduar në këtë institucion, ka qenë si më poshtë vijon:

- Shtator 2022            308 të dënuar
- Tetor 2022             302 të dënuar
- Nëntor 2022            330 të dënuar
- Dhjetor 2022          326 të dënuar
- Janar 2023             327 të dënuar
- Shkurt 2023            313 të dënuar

---

<sup>1</sup> Shkresë nr.K4/I15-2 prot., datë 22.09.2022 “Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të burgosurve në IEVP Rrogozhinë”.

Nisur nga statistikat e mësipërme, rezulton se, në IEVP Rrogozhinë nuk ka patur situata të mbipopullimi. Avokatii Popullit shpreh vlerësimin për arritjen e këtij standardi.

Bazuar në Urdhërin nr.174, datë 19.10.2022 të Kryeministrit të Shqipërisë, struktura dhe organika e IEVP Rrogozhinë **përbëhet nga 176 punonjës**, nga të cilët 39 punonjës civil dhe 137 punonjës të sektorit të policisë së burgut. Gjatë inspektimit, u evidentuan mungesa në stafin e institucionit që konsistonin në specialist jurist (1), specialist punonjës social (1), mjek i përgjithshëm (1), infermier (1), specialist policie (oficer) 2, si dhe punonjës policie i rolit bazë (15). Nga informacioni i drejtuesve të institucionit, në lidhje me garantimin e sigurisë dhe shërbimet që duhet t'u ofrohen të të dënuarve, mungesat në organikë mbuloreshin nga pjesa tjetër e stafit aktual. Por, pavarësisht kësaj është urgjente që Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të plotësojë vendet vakante, pasi ato zenë 15% të numrit të punonjësve të miratuar në organikë dhe kanë zgjatur për një periudhë të gjatë<sup>2</sup>.

Në përgjigje të rekomandimeve të MKPT-së, Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve me shkresën nr.11120/1 prot., datë 26.10.2022 drejtuar Avokatit të Popullit, midis të tjerave na informon se: *“DPB ka përgatitur projekt-preventivin për rikonstruktimin e plotë të IEVP Rrogozhinë. Por fondet e alokuara për vitin 2022 nuk e kanë parashikuar zbatimin e këtij zëri. Theksojmë se e kemi prioritet zbatimin e këtij rekomandimi sa më parë”*.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve nga inspektimi i mëparshëm, sipas informacionit të drejtuesve të institucionit dhe gjetjeve të inspektimit, situata rezultoi si më poshtë vijon:

1. Me fondet e institucionit, ishin kryer disa investime të pjesëshme në ambientet e dhomave të banimit dhe të dusheve në godinën nr.1 dhe nr.2, për eliminimin e kabllove dhe të lagështirës në mure.
2. Ishte realizuar rekomandimi, për plotësimin e vendeve vakante në pozicionin e zv/drejtorit të IEVP-së, përgjegjësit të sektorit të çështjeve shoqërore të institucionit, si dhe pozicionit të punonjësve të policisë të rolit bazë.
3. Në hyrje të regjimit të brendshëm të institucionit, ishte krijuar një ambient modest, për takimet e të dënuarve me fëmijët dhe familjarët e tyre.
4. Ishte realizuar rekomandimi, për lidhjen e kontratave të punës dhe kryerjen e pagesave me të punësuarit në institucion, në zbatim të VKM-së nr.602 datë 13.10.2021.
5. Ishte realizuar rekomandimi, për krijimin e një klase për zhvillimin e mësimin për arsimin 9 vjeçar, sipas kërkesave të të dënuarve.
6. Ishte plotësuar rekomandimi, për afishimin në vende të aksesueshme për të dënuarit i numrave të telefonit për të komunikuar me Avokatin e Popullit, por nuk ishte aktive lidhja me këta numra.

---

<sup>2</sup> Viti 2019 – 3 staf civil dhe 5 punonjës policie;  
viti 2020 – 2 staf civil dhe 8 punonjës policie;  
viti 2021 – 1 staf civil dhe 9 punonjës policie  
viti 2022 – 2 staf civil dhe 7 punonjës policie.

7. Ishte plotësuar rekomandimi, për krijimin e regjistrit me qëllim evidentimin dhe protokollimin e kërkesë/ankesave të të dënuarve, si dhe ndjekjen ritmike të ecurisë për zgjidhjen e tyre nga punonjësit e stafit të institucionit.

Ndërkohë, u evidentua se disa nga rekomandimet **nuk** ishin plotësuar. Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, arsyeja ka qenë mungesa e fondeve buxhetore për investime në rikonstrukcionin e plotë të godinave të institucionit, si dhe mundësitë e kusstëzuara që ofron infrastruktura në regjimin e brendshëm të institucionit, konkretisht:

1. Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve social-kulturore me pjesëmarrjen masive të të dënuarve, që ti shërbejnë rehabilitimit të tyre dhe kalimit të kohës së lirë.
2. Lagështira vazhdonte të ishte prezente, kryesisht në dhomat e banimit dhe në ambientin e dusheve në godinën nr.3, si dhe në ambientin e observimit dhe të veçimit të këtij institucioni.
3. Furnizimi me ujë i ambienteve në regjimin e brendshëm kryhej me orar të reduktuar dhe nuk plotësonte nevojat e të dënuarve për larjen e trupit, si dhe mbajtjen e pastërtisë e të higjenes së ambienteve të përbashkëta.
4. Pavarësisht disa investimeve, gjendja e dhomave në ambientin e observimit dhe të veçimit është në kushte jo të përshtatshme për jetesë, duke përbërë trajtimi jo dinjitoz për të dënuarit që qëndronin në këto ambiente, qoftë edhe sipas afateve kohore të parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.
5. Në ambientet e regjimit të brendshëm, nuk ishte kryer zëvendësimi i posterave të vjetëruar me të drejtat e të burgosurve, me postera të rinj, si dhe vendosja e tyre në vende të aksesueshme nga të dënuarit.
6. Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për shtimin e numrit të kamerave të sigurisë në ambientet e brendshme të institucionit, kryesisht në ato ambiente që nuk mbulohen nga kamerat ekzistuese të sigurisë, me qëllim parandalimin e veprimeve të kundraligjshme ndaj të dënuarve.

Inspektimi i grupit të MKPT-së në I EVP Rrogozhinë, u krye sipas metodologjisë së inspektimit pa paralajmërim, si dhe pa mbikqyrjen e stafit të institucionit në zhvillimin e intervistave konfidenciale me të dënuarit.

Drejtuesit dhe stafi i institucionit ishin bashkëpunues me grupin e MKPT-së gjatë kryerjes së inspektimit, i cili gjithashtu u zhvillua edhe në përputhje me procedurat e parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

### **Trajtimi i të dënuarve**

Grupi i inspektimit të MKPT-së zhvilloi një numër të konsiderueshëm intervistash konfidenciale me të dënuarit, në lidhje me trajtimin e tyre nga stafi i institucionit dhe

kryesisht nga punonjësit e policisë që kryejnë shërbim në regjimin e brendshëm, me qëllim identifikimin e rasteve të dhunës, përdorimin e forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative apo ushtrimit të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie.

Nga intervistat e zhvilluara me të dënuarit, grupi i inspektimit nuk mori asnjë ankesë dhe nuk evidentoi raste apo pretendime prej tyre, për keqtrajttime dhe tejkallim të forcës fizike nga punonjësit e sigurisë të këtij institucioni. Raporti dhe marrëdhëniet e stafit të institucionit dhe punonjësve të policisë me të dënuarit, kanë qenë korrekte dhe në zbatim të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

Vëmendje të veçantë ju kushtua kqyrjes së procedurave që ndiqen nga stafi i institucionit për trajtimin e kërkesë/ankesave të të dënuarve nga administrata e institucionit, krijimin më vehte të një regjistri për evidentimin e tyre, si dhe për respektimin e afateve në zgjidhjen e tyre. Nga kqyrja e dokumentacionit rezultoi se, kjo praktikë ndiqej nga punonjësit e sektorit të çështjeve shoqërore, të cilët pasi e merrnin formularin e plotësuar të kërkesës/ankesës nga i dënuari, e regjistronin në regjistër dhe e dorëzonin te drejtori i institucionit. Më tej, ai ngarkonte punonjës të përgjegjës për trajtimin e saj dhe kthimin e përgjigjes të dënuarit<sup>3</sup>. Për vitin 2023 ishin evidentuar 108 kërkesa nga të dënuarit me objekt takime me familjen, për lidhje me skype, për punësim, vizitë mjeksore te mjeku specialist, njohje me dinamikën, të cilat rezultonin të pranuar dhe të zgjidhura nga stafi i institucionit.

Një aspekt i inspektimit, ishte dhe verifikimi i dokumentacionit të administruar nga I EVP dhe korrespondenca me komisionin e apelit pranë DPB-së, për shqyrtimin e ankimeve të të dënuarve, në rastin e pretendimit për shkelje apo mohim i të drejtave të ligjshme të tyre nga I EVP. Ky komision ishte ngritur me urdhër të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe funksiononte mbi bazën e procedurave të parashikuara në rregulloren e përgjithshme të burgjeve<sup>4</sup>. Grupi i inspektimit nuk mori ankesa nga të dënuarit për procedurat e ndjekura nga këto komisione.

Nga intervistat e zhvilluara me të dënuarit, u paraqitën një numër i konsiderueshëm ankesash që kishin të bënin me **nivelin e lartë të lagështirës** në dhomat e banimit, si dhe në ambientet e përbashkëta (dushe), e cila ndikon në uljen e cilësisë së jetesës dhe dëmton shëndetin e të dënuarve. Pavarësisht disa investimeve të pjesëshme të kryera në dhomat e banimit, në ambientin e infermierisë, si dhe në ambientin e veçimit dhe të observimit me fondet e institucionit dhe Shoqatës Kristiane të të Burgosurve Shqiptarë (SHKBSH), niveli i lagështirës ishte ende i lartë. Kjo situatë, ishte si pasojë e amortizimit të godinave në regjimin e brendshëm, si dhe faktit që ato nuk kanë qenë të ndërtuara për banim, por janë përshtatura si të tilla gjatë viteve më pas.

---

<sup>3</sup> Neni 34 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve thuhet shprehimisht se: “Çdo institucion mban dhe përditëson regjistrin e kërkesave ose ankesave të të burgosurve, në formë shkresore dhe elektronike. Kërkesa ose ankesa, pasi regjistrohet në regjistër i dorëzohet drejtorit të institucionit, i cili ngarkon punonjës të përgjegjës për trajtimin e saj dhe kthimin e përgjigjes të burgosurit”.

<sup>4</sup> Neni 90,91,92,93 dhe 94 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

Një numër ankesash, kishin të bënin me mungesën e aktiviteteve të larmishme kulturore-sportive dhe me pjesmarrjen masive të të dënuarve. Sipas informacionit, zhvillimi i këtyre aktiviteteve bëhet i pamundur për shkak të mungesës të ambienteve në regjimin e brendshëm, si dhe për arsye sigurie për shkak të konflikteve mes të dënuarve. Aktivitetet e vetme që zhvilloheshin ishin ato në grupe dhe në bazë sektori si ajrimi, lojrat e tavolinës dhe ushtrimi në palestra, sipas një grafiku të miratuar nga drejtori i institucionit.

Një problematikë e ngritur nga të dënuarit, kishte të bënte me lejet shpërblyese<sup>5</sup>, të cilat janë ndërprerë me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, në zbatim të masave për parandalimin e përhapjes së pandemisë Covid-19. Ndërkohë, që në sistemin penitenciar janë shfuqizuar të gjitha masat kufizuese, e drejta e të burgosurve për të përfituar leje shpërblyese ende nuk është lejuar. Sipas informacionit, kjo masë ende nuk është shfuqizuar nga Ministri i Drejtësisë, pasi procedurat e lejeve shpërblyese përcaktohen në udhëzimin që miraton rregullat dhe procedurat për dhënien e lejeve shpërblyese<sup>6</sup>. Pavarësisht situatës të krijuar post-Covid 19, vonesat në miratimin akteve nënligjore për aplikimin e të burgosurve për lejeve shpërblyese, përbën shkelje të të drejtave ligjore për këtë kategori.

Nga verifikimi i akteve ligjore të miratuara në kuadër të pandemisë, rezulton se, Ministri i MSHMS ka nxjerrë urdhër nr.273, datë 26.04.2022 *“Për shfuqizimin e urdhër nr.351, datë 29.05.2020 “Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizuese për parandalimin e përhapjes së COVID-19”, të ndryshuar”*.

Për më tepër, më datë 05 Maj 2023 edhe OBSH ka deklaruar përfundimin e Pandemisë COVID-19 e situata në lidhje me kufizimet për shkak të saj duhet ti kthehet normalitetit.

Pra, në aspektin ligjor, nuk ka pengesa për respektimin e të drejtës të të dënuarve për të përfituar leje shpërblyese, ndaj mosnxjerrja e aktit nënligjore që përcakton procedurat që duhet të ndiqen nga IEVP dhe DPB për këtë qëllim, përbën shkelje të dispozitave ligjore.

Në aspektin psiko-social, mos aplikimi i lejeve shpërblyese, ndikon në mungesën e motivimit të të burgosurve për të marrë pjesë në aktivitetet dhe programet rehabilituese e të ri-integrimit. Ato janë të nevojshme edhe për të ruajtur lidhjet e tyre me familjarët dhe përgatitjen për tu kthyer pas përfundimit të dënimit. Ndaj është e domosdoshme nxjerrja sa më parë e udhëzimit për dhënien e lejeve shpërblyese për të burgosurit, si një e drejtë e përcaktuar në ligj dhe në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

---

<sup>5</sup> Neni 59 i ligjit 81/2020: *“Të dënuarit, të cilët respektojnë rregullat e disiplinës dhe rregulloren e brendshme të institucionit, që janë të motivuar për të marrë pjesë në programet rehabilituese e të riintegritit dhe nuk paraqesin rrezikshmëri shoqërore, kanë të drejtë të marrin leje shpërblyese, por jo më shumë se 20 ditë në vit.*

<sup>6</sup> Neni 59 i ligjit 81/2020 thuhet shprehimisht se: *“Procedurat e dhënies së lejeve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë”*.

Në lidhje me trajtimin ushqimor nga institucioni, të dënuarit nuk ngritën ankesa, pasi në tërësi të intervistuarit deklarorin se, gatuanin në ambientet e krijuara për secilin sektor, me ushqimet e dërguara nga familjarët e tyre. Nga kqyrja e këtyre ambienteve të gatimit, u evidentua se ato nuk ishin të lyera dhe me kushte jo të mira higjieno-sanitare. Gjithashtu, kabllot elektrik që përdoren për gatim janë të varura në mure dhe mungojnë instalimet e brendshme elektrike, duke cënuar elementët e sigurisë dhe të jetës të të dënuarve. Njëkohësisht, për shkak të përdorimit të pajisjeve elektrike, rrjeti i brendshëm të furnizimit me energji elektrike, pësonte difekte të shpeshta.

Ngrohja e ambienteve në regjimin e brendshëm, në mungesë të një sistemi qëndror ngrohje/ftohje, realizohej me paisje elektrike të siguruara nga të dënuarit, të miratuara nga drejtuesit e institucionit. Por, një pjesë e të dënuarve ngritën ankesa për mungesën e ngrohjes, pasi jo të gjithë kishin mundësitë financiare për të siguruar pajisje elektrike gjatë periudhës së dimrit. Gjithashtu, institucioni nuk kishte fonde buxhetore për të kompletuar me pajisje elektrike të dënuarit në pamundësi financiare. Sipas informacionit, godinat në regjimin e brendshëm janë godina të adoptuara, ndaj institucioni nuk ka patur në asnjë kohë sistem qëndror për ngrohje/ftohje, por kanë lejuar hyrjen në regjim të pajisjeve elektrike alternative.

Mungesa e ujit të rrjedhshëm dhe cilësia e ujit, ishte një ankesë e ngritur nga të dënuarit. Furnizimi me ujë i ambienteve kryhej 3 herë në ditë me orar të reduktuar, por koha ishte e pamjaftueshme për mbajtjen e higjienës personale dhe njëkohësisht për mbajtjen e pastërtisë së ambienteve të banimit. Ata deklarorin se, uji nuk është i cilësisë së mire dhe nuk mund të përdoret për tu pirë dhe as për gatim. Uji i pijshëm blihej nga të dënuarit nëpërmjet “Marketit online”, duke rritur kostot e buxheteve të familjeve të tyre. Furnizimi me ujë të pijshëm i të burgosurve është një e drejtë që duhet të sigurohet nga institucioni<sup>7</sup>.

Grupi i inspektimit, kërkoi gjithashtu një informacion edhe në lidhje me investimet që do të kryhen në I EVP Rrogozhinë për vitin 2023, por rezultoi se, nuk kishte investime të planifikuara me fondet e buxhetit të shtetit. Projektet më me prioritet që duhet të investohen, sipas informacionit, ishin projektet për shkarkimin e ujrave të bardha dhe ujrave të zeza, si dhe projektet për rikonstruksionin e plotë të rrjetit elektrik në regjimin e brendshëm.

### **Masat mbrojtëse**

Grupi i monitorimit të MKPT-së, kërkoi informacion në lidhje me procedurat që ndiqen nga komisioni i pritjes të të dënuarve në institucion, komisioni disiplinor për dhënien e masave disiplinore, si dhe për mënyrën e plotësimit të regjistrave dhe dosjeve psiko-sociale të të dënuarve.

---

<sup>7</sup> Neni 27 i ligjit 81/2020 thuhet shprehimisht se: “Të paraburgosurit dhe të dënuarve duhet t’u sigurohet në vazhdimësi ujë i pijshëm”.

Nga verifikimi i dokumentacionit i venë në dispozicion nga stafi i institucionit, u evidentua se në IEVP Rrogozhinë, komisioni për pranimin në institucion të të dënuarve të rinj, komisioni për dhënien e masave disiplinore, si dhe procedura për përditësimin e formularit për vlerësimin e sjelljes së të dënuarve, funksiononin sipas procedurave të parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve<sup>8</sup>.

Komunikimi me telefon i të dënuarve me familjarët e tyre, kryhej nëpërmjet telefonave me kartë 8 herë në muaj, të instaluar në mjediset e secilit sektor në regjimin e brendshëm. Numrat e telefonit të institucionit të Avokatit të Popullit ishin të afishuar në korridoret e sektorëve. Nga verifikimi i numrit të telefonit të Avokatit të Popullit (numri jeshil tel: 08001111 dhe tel: +355 42380300), rezultoi se të dënuarit nuk mund të komunikonin (pa pagesë) me institucionin tonë dhe rrjedhimisht as me telefonat e organizatave të tjera në fushën e mbrotjes të të drejtave të njeriut.

Në lidhje me këtë problematikë, drejtuesit e institucionit do të komunikonin menjëherë me përfaqësuesit e kompanisë telefonike, për të zgjidhur të drejtën e komunikimit të të dënuarve me institucionin tonë dhe organizatat që veprojnë në fushën e mbrotjes të të drejtave të të burgosurve. Numrat e kontaktit të të burgosurve me Avokatin e Popullit, përbëjnë një garanci për mbrotjen e të drejtave të tyre, por në kushtet kur kjo mundësi është e kufizuar, përbën premisë në cënimin e të drejtave që ju jep ligji.

Vizitat e të dënuarve me familjarët kryheshin rregullisht 4 herë në muaj, nga të cilat 3 takime fizike dhe 1 takim online<sup>9</sup>. Institucioni ka 3 ambiente për takime fizike me familjarët, nga një ambient takimi për secilën godinë. Këto mjedise ishin të kompletuara me stola për qëndrimin ulur të personave dhe ndahen në mes nga mur me skarrë hekuri, ku të dënuarit mund të takohen fizikisht me familjarët e tyre. Ambienti i takimeve online kryhej në një dhomë në hyrje të regjimit të brendshëm, i pajisur me një kompjuter për komunikimin me skype.

Procedurat e takimit të të dënuarve me familjarët, zhvilloheshin çdo ditë sipas listës të miratuar nga drejtori i IEVP-së. Nga intervistat me të dënuarit nuk u paraqitën ankesa në lidhje me procedurat për takimin dhe komunikimin me telefon me familjarët e tyre.

Ambienti i veçimit, observimit dhe i tranzitit ndodhet në një godinë më vehte në regjimin e brendshëm. Godina ishte e amortizuar dhe me lagështirë në ambientet e brendshme të dhomave ku qëndronin personat me masë disiplinore, si dhe hyrjet e reja në institucion. Në momentin e inspektimit, në dhomat e veçimit ndodheshin 3 të dënuar me masë disiplinore (2 prej tyre në “mbikqyrje të veçantë” dhe 1 i dënuar me 14 ditë veçim nga aktivitetet e institucionit). Ndërsa, në dhomat e observimit ndodheshin 7 persona, prej tyre

---

<sup>8</sup> Neni 11, 30 dhe 54/1 të ligjit 81/2020.

<sup>9</sup> Neni 70 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve miratuar me VKM nr.209, datë 06.04.2022.: “Të burgosurit kanë të drejtën e zhvillimit të vizitës të paktën 4 (katër) herë në muaj me anëtarët e familjes ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes, me një kohëzgjatje të paktën 1 (një) orë.... Të burgosurit kanë të drejtë të zëvendësojnë 1 (një) vizitë fizike me atë online”.



4 të dënuar ishin prurje të reja ndërsa 3 të dënuar qëndronin në këto ambiente për shkak të konflikteve dhe mospërshtatjes me bashkëvuajtësit e tjerë, në asnjërin prej sektorëve të këtij institucioni.

Në kushtet kur këta të dënuar nuk ishin përshtatur dhe integruar në sektorët e regjimit të brendshëm të këtij institucioni, IEVP Rrogozhinë kishte njoftuar me informacion me shkrim DPB, për të mundësuar transferimin e tyre në institucione të tjera.

Institucioni i Avokatit të Popullit, sjell në vëmendjen tuaj se, në rastin kur një regjim i tillë imponohet ose zbatohet me kërkesë nga vetë i dënuari për arsye mospërshtatje, një garanci thelbësore është prezenca e vazhdueshme e mjekut në ambientet e observimit, me synimin që personeli mjekësor të kryejë vëzhgimin dhe ekzaminimin mjekësor të të burgosurve në mënyrë të vazhdueshme. Rezultatet e këtyre ekzaminimeve, përfshirë këtu dhe një përshkrim të gjendjes fizike dhe mendore të tyre, si dhe pasojat e parashikueshme të izolimit të vazhduar, duhet t'u paraqiten rregullisht me anë të një deklaratë me shkrim nga ana e mjekut, autoriteteve kompetente për çështjet e regjimit dhe sigurisë në IEVP. Pavarësisht se kjo praktikë zbatohet në këtë institucion, DPB duhet ta shikojë me prioritet mundësinë e transferimit të menjëhershëm të këtyre të dënuarve në IEVP të tjera.

Ambientet e IEVP Rrogozhinë mbulohen nga 48 kamera sigurie që janë të instaluar në regjimin e brendshëm dhe të jashtëm dhe shërbejnë për monitorimin dhe vëzhgimin e ambienteve. Me qëllim rritjen e sigurisë fizike të të dënuarve, si dhe parandalimin e veprimeve të kundraligjshme nga punonjësit e policisë ndaj tyre, institucioni kishte kërkuar DPB-së shtimin e numrit të kamerave të sigurisë për mbulimin e korridoreve brenda sektorëve në regjimin e brendshëm, si dhe në sektorin e veçimit dhe të observimit. Monitorimi me kamera kryhet përgjatë 24 orëve dhe pamjet filmike ruhen deri në 30 ditë. Administrimi i rrjetit kryhet nga specialisti i IT-së së institucionit.

Grupi inspektimit verifikoi respektimin e të drejtës për informimin e të dënuarve me të drejtat e tyre. Posterat me të drejtat që gëzojnë të burgosurit, ishin të vendosur në vende të aksesueshme nga të dënuarit si në ambientet e korridoreve të dhomave të banimit, si dhe në ambientet e përbashkëta të klasave dhe në bibliotekën e institucionit. Pavarësisht kësaj, u evidentua se posterat ishin të vjetëruar dhe kishin nevojë të zëvendësoheshin me postera të rinj.

Në IEVP Rrogozhinë, organika e të punësuarve ishte e miratuar për 20 persona, por në momentin e inspektimit ishin të punësuar 17 persona në pozicione si ndihmës kuzhiner, berber, lavanderi, sanitarë etj. Të punësuarit, nuk paraqitën ankesa në lidhje me kushtet e punës dhe pagesat e shpërblimit financiar mbi punën e kryer pasi ishin kryer rregullisht sipas listë pagesave për çdo muaj<sup>10</sup>.

---

<sup>10</sup>Nga informacioni ka filluar lidhja e kontratave ndërmjet IEVP dhe të burgosurve të punësuar, për pagesat e ditëve të punës.

Të dënuarit e moshës 18-21 vjeç (gjithsej 3 të dënuar) ishin të shpërndarë në tre godinat e banimit, sipas nevojave për përshtatje, si dhe vlerësimit psiko-social dhe identifikimit të faktorëve të rrishtit, të kryer nga specialistët e sektorit të çështjeve shoqërore. Në këto kushte, këta të dënuar ishin akomoduar në dhoma me të dënuarit e tjerë. Përsa i takon aktivitetet psiko-sociale me këtë grup moshë, ato zhvillohen më vehte nga specialistët e çështjeve shoqërore, ndërsa orari i ajrimit kryhej në orare të njëjta me të dënuarit e tjerë.

Nga intervistat me stafin e institucionit, u informuam në lidhje me marrjen e masave në bashkëpunim me Bashkinë Rrogozhinë, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Kodi Zgjedhor dhe udhëzimet e Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet, me qëllim garantimin e të drejtës së votës së të burgosurve, për zgjedhjet vendore që do të zhvillohen në datë 14 maj 2023.

Nga stafi i institucionit, ishin marrë masa për ngritjen e QV-së në ambientin e takimeve në regjimin e brendshëm, si dhe ishte bërë verifikimi i dosjeve të të dënuarve, me qëllim përfshirjen e tyre në listën e zgjedhësve. Në bazë të kërkesave të nenit 2, pika 1, të ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, nga 315 të dënuar, 105 prej tyre plotësonin kriteret për të ushtruar të drejtën e votës.

### **Kushtet materiale**

Grupi i inspektimit verifikoi kushtet infrastrukturore në regjimin e brendshëm si dhomat e banimit, dhomat e veçimit e të observimit, si dhe ambientet rekreative, të cilat përbëjnë tërësinë e elementëve që duhet të plotësohen nga institucionet e burgjeve, për jetesë normale të të burgosurve.

Kushtet e jetesës në institucion, janë të parashikuara në nenin 32 dhe 33 të ligjit nr.81/2020, ku thuhet shprehimisht se: *“Mjediset që u ofrohen të burgosurve dhe në veçanti mjediset e fjetjes respektojnë dinjitetin njerëzor dhe, sa më shumë të jetë e mundur, privatësinë, si dhe plotësojnë kërkesat shëndetësore dhe higjienike, duke u kushtuar rëndësinë e duhur kushteve të klimës, hapësirës së nevojshme, përmbajtjes kubike të ajrit, ndriçimit, ngrohjes dhe ajrimit”*.

Gjendja e ndërtesave, ku ndodhen zyrat e administratës dhe godinat e banimit në regjimin e brendshëm, janë të amortizuara. Këto godina janë ndërtuar në vitin 1958 dhe janë përdorur si magazina, por me krijimin e I EVP-së Rrogozhinë, ato janë përshtatur si ambiente banimi për të burgosurit. Në këto kushte, lind nevoja që DPB të rishikojë në dinamikë kapacitetin fizik të këtij institucioni dhe numri i të dënuarve që duhet të akomodohen në këto ambiente, të përcaktohet jo sipas numrit të shtretërve, por sipas kushteve teknike që plotësojnë ambientet në regjimin e brendshëm për jetesë normale.

Në regjimin e brendshëm ndodhen 3(tre) godina, të ndarë në sektorë dhe apartamente të përshtatura për banim, ambiente gatimi dhe ambiente tualeti dhe dushi i përbashkët për

larjen e trupit. Godina nr.1 ka në përbërje 4 sektorë, ndërsa godina nr.2 dhe godina nr.3 kanë nga 3 sektorë secila. Në zbatim të urdhërit nr.3171 prot., datë 05.04.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, në të gjithë sektorët janë sistemuar vetëm të dënuarit e sigurisë së zakonshme. Në godinën nr.1 dhe 2, vitet e fundit janë kryer disa investime të pjesëshme në rikonstruksionin e dhomave të banimit, ndërsa në godinën nr.3 është e nevojshme ndërhyrja e menjëhershme me investime, për mirëmbajtjen e ambienteve të jetesës për të dënuarit.

Çdo apartament ka në përbërje nga 2 (dy) dhoma banimi që lidhen mes tyre me një korridor të vogël, i cili shërben njëkohësisht edhe si ambient për gatimin e ushqimit. Tualeti është i përbashkët për secilën dhomë, i cili shërbente njëherësh edhe si ambient dushi për larjen e trupit.

Në momentin e inspektimit, në dhomat e banimit ishin akomoduar 4, 6 dhe 8 persona. Referuar kubaturave dhe sipërfaqeve të dhomave të banimit të lejshme për çdo të burgosur, të parashikuara në ligjin nr.81/2020 “Për trajtimin dhe të drejtat e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe standardet ndërkombëtare për këtë qëllim, dhomat e banimit **nuk** i plotësonin kushtet dhe kriteret për jetesë normale për të dënuarit<sup>11</sup>.

Dritaret e dhomave janë me përmasa të tilla që mundësojnë ndriçim natyral dhe ajrosje të përshtatshme të ambienteve. Pastërtia dhe kushtet higjieno sanitare në dhomat e banimit, në korridoret dhe tualetet e përbashkëta, ishin përgjithësisht të mira, për shkak dhe të amortizimit të këtyre godinave.

Ngrohja në ambientet e banimit realizohej me ngrohëse elektrike që siguroheshin nga familjarët e të dënuarve, pasi institucioni nuk kishte sistem qendror ngrohje/ftohje. Gjithashtu dhe gatimi i ushqimit nga të dënuarit, kryhej me pajisje elektro-shtëpiake të siguruar nga familjarët e tyre.

Nga intervistat me të dënuarit u informuam se, larja e trupit kryhej rregullisht 4 herë në muaj dhe në varësi të stinës edhe 2 herë në javë. Dushet ishin të instaluar në të njëjtin ambient të përbashkët me tualetet. Ata ngrinin me shqetësim faktin se, ambienti i dusheve dhe pajisjet elektrike të instaluar brenda tyre, me kablo të varura në pjesën e jashtme të mureve, çënojnë sigurinë e jetës së të dënuarve, pasi ato duhet të jenë të vendosura brenda në mure, sipas kushteve teknike dhe atyre të sigurisë.

Sikurse u theksua edhe më lart, një problematikë e evidentuar nga grupi i inspektimit, kishte të bënte me furnizimin me ujë të institucionit, i cili kryhej me orar të reduktuar 3 herë në ditë nga 2 orë, nga rrjeti i ujësjellësit të qytetit të Rrogozhinë. Koha e shkurtër e

---

<sup>11</sup> Neni 33 i ligjit nr.81/2020 thuhet shprehimisht se: “Në vendosjen e të burgosurve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo institucioni të ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe kushtet e mundësitë e të burgosurve, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9 m<sup>3</sup> dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m<sup>2</sup> për çdo të burgosur, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar”.

furnizimit me ujë, nuk u jepte mundësinë të dënuarve për larjen e trupit sipas grafikut dhe njëkohësisht për mbajtjen e pastërtisë të ambienteve të dhomave dhe korridoreve të përbashkëta.

Në lidhje me mbajtjen e higjenës në kushtet e burgimit, në pikën 19.4 të Rregullave Evropiane të Burgjeve thuhet shprehimisht se, *“Çdo të burgosuri duhet t’i sigurohen kushte të përshtatshme në mënyrë të tillë që të bëj dush, me ujë në temperaturë të përshtatshme me klimën. Kur është e mundur dushi mund të bëhet çdo ditë, ose të paktën dy herë në javë (ose më shpesh nëse është e nevojshme) në interes të higjenës së përgjithshme”*<sup>12</sup>.

Gjatë inspektimit u evedentua se, dhomat e banimit ishin të kompletuara me materiale për fjetje dhe me orenditë e nevojshme si tavolina, karrige dhe komodina, për një jetesë normale. Në intervistat me të dënuarit, nuk u paraqitën ankesa në lidhje me furnizimin me materiale fjetje dhe orenditë e nevojshme për mbajtjen e sendeve personale dhe të ushqimeve. Të dënuarit deklarorin se një pjesë e tyre këto materiale i kishin siguruar nga familjarët e tyre, por edhe materialet e fjetjes të institucionit, ishin në gjendje të mirë përdorimi. Në mungesë të dollapeve, të dënuarit i mbanin sendet e tyre personale në komodina.

Në intervistat me të dënuarit, u evidentua se furnizimi me detergjente dhe materiale higjenike, për mbajtjen e higjenës personale dhe të ambienteve të përbashkëta, kryhej rregullisht çdo muaj nga sektori i logjistikës në bashkëpunim me sektorin e policisë të institucionit. Por, në kushtet e amortizimit dhe të lagështirës që kanë godinat e banimit, nevojitet që të dënuarit të furnizohen me detergjente dhe materiale higjenike shtesë mbi normativën e lejueshme mujore, pasi në kushtet që janë, lagështira dhe mungesa e pastërtisë, dëmtojnë shëndetin e personave që qëndrojnë për kohë të gjatë në këto ambiente.

Lidhur me këtë problematikë, të dënuarit deklarorin se ambientet e dhomave të banimit, tualetet, koridoret dhe klasat e edukimit ishin dezinfektuar pothuajse çdo javë gjatë periudhës së pandemisë. Aktualisht, ishte duke u kryer dizifektimi 3D (*DEZINFEKTIM – DEZINSEKTIM – DERATIZIM*), sipas grafikut (3 herë në vit) nga subjekt privat i kontraktuar për këtë qëllim, për eliminimin e parazitëve, furrtarëve dhe insekteve të tjerë.

Larja e materialeve të fjetjes (çarçafë dhe batanije) dhe rrobave të trupit të të dënuarve, kryhej në lavanterinë e institucionit pajisjet e së cilës ishin vendosur në një ambient më vehte, me hapësirë dhe ishte funksionale. Ajo ishte e kompletuar me 11 lavatriçe ku ishte punësuar një i dënuar, sipas organikës të institucionit. Një pjesë e të dënuarve, deklarorin se rrobat e trupit, dërgoheshin për t’u larë edhe pranë familjeve të tyre.

---

<sup>12</sup> <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?>

Kuzhina e institucionit ishte funksionale dhe e kompletuar me pajisjet e nevojshme për gatimin dhe shpërndarjen e ushqimit. Në ambientin e kuzhinës ishin kryer disa investime për mirëmbajtjen e mureve, ajo ishte e lyster dhe e pastër nga ana higjieno-sanitare. Për shkak të problematikave, vitin e fundit ishte bërë e mundur investimi në kanalizimin për shkarkimin e ujrave të kuzhinës.

Ushqimi gatuhej për 3 vakte dhe ishte i një cilësie të pranueshme. Menyja e ditës ishte e afishuar në kuzhinë, sipas gramaturave ushqimore dhe e ndarë sipas kategorive më vehte për të dënuarit, për të dënuarit e punësuar dhe për të sëmuret me dietë ushqimore (diabet). Kampionët e ushqimit ruheshin në kushte frigoriferike, të vendosur në disa gota porcelani, por kampionët **nuk** ishin të mbyllur me kapak dhe nuk ishin të individualizuar me etiketa, sipas vakteve ushqimore. Kuzhina ishte e kompletuar me 2 frigorifer ngrirës, një frigorifer ftohës dhe një aspirator. Stafi i kuzhinës ishte i plotësuar sipas organikës me 4 punonjës civil dhe 3 ndihmëskuzhiner (përveç të punësuarve që shpërndanin ushqimin sipas godinave) nga rradhët e të dënuarve të punësuar. Stafi i kuzhinës, ishte i pajisur me libreza shëndetësore.

Nga inspektimi në dhomat e seksionit të veçimit dhe të observimit, u konstatua gjithashtu se kushtet infrastrukturore, nuk i përgjigjeshin kushteve për jetesë normale. Dhomat janë me përmasa të vogla, muret e brendshme të ambienteve janë të dëmtuara, si dhe ka lagështirë në pjesën e tavanit të godinës. Në këto dhoma janë kryer disa investime të pjesshme nga ana e institucionit, por gjendja e tyre vijon të jetë problematike, për shkak të gjendjes jo të mirë teknike dhe amortizimit të godinës.

Tualetet dhe dushet ishin të përbashkëta për çdo apartament, të pajisura me nje hidrosanitare, rubineta dhe lavaman të rinj, si dhe me dyer alumini.

### **Regjimi dhe aktivitetet**

Regjimi ditor dhe aktivitetet me të dënuarit në IEVP Rrogozhinë, zhvilloheshin sipas orarit të veprimeve ditore, të miratuar nga drejtori i institucionit. Sektori i çështjeve shoqërore kishte të miratuar programe mujore për zhvillimin e aktiviteteve me të dënuarit në bazë sektori dhe me grupe të dënuarish. Në dosjet e sektorit të çështjeve shoqërore, ndodhej edhe programi për këshillimet individuale, sipas interesave dhe nevojave të paraqitura nga të dënuarit, por të ndarë edhe sipas grup moshave.

Stafi i sektorit të çështjeve shoqërore ka në organikë 7 punonjës, në përbërje 1 shef sektori, 2 psikolog dhe 4 punonjës social. Aktualisht, në stafin e këtij sektori mungon 1 specialist punonjës social.

IEVP Rrogozhinë është institucion i hapur, ku për shkak të infrastrukturës, të dënuarit sipas sektorëve kalojnë një kohë të konsiderueshme në ambientet jashtë dhomave të banimit. Por, sikurse e përmendëm më lart, të dënuarit paraqitën ankesa në lidhje me mungesën e aktiviteteve kulturore-sportive me pjesmarrjen e gjerë të të dënuarve. Aktivitetet e vetme që kryheshin ishte ajrimi, lojrat e tavolinës dhe ushtrimi në palestër

Në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, aktivitetet duhet të jenë të larmishme, pasi një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është ri-integrimi në shoqëri i këtyre personave, në momentin kur ata do të lenë burgun. Lidhur me këtë qëllim, Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se: *“regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*<sup>13</sup>.

Në këtë kuadër, sektori i çështjeve shoqërore duhet të hartojë programe këshillimi për trajtimin individual të të dënuarve sipas grup moshave, por të ndërthurur me zhvillimin e aktivitete me grupe të dënuarish, me qëllim që ata të kenë mundësi të ndërveprojnë me njëri tjetrin, si dhe të mbushin sado pak atë boshllëk psikologjik dhe edukativ, që krijohet te këta persona nga mungesa e aktiviteteve kulturore dhe sportive, gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit.

Bibloteka e institucionit ishte funksionale dhe ishte furnizuar me libra të rinj. Një i dënuar ishte i punësuar në bibliotek, e mirëmbante atë dhe plotësonte kartelat për çdo të dënuar që kishte interes për leximin e librave. Në këtë institucion, ishin funksionale dhe 2 ambiente kulti për besimtarët myslyman dhe për besimtarët e krishterë, të cilat funksiononin sipas kalendarit të këtyre besimeve fetare.

Ajrimi i të dënuarve realizohej sipas orarit ditor, por në mënyrën që janë të organizuara godinat në regjimin e brendshëm të institucionit, të dënuarit qëndronin në ajrim edhe jashtë këtij orari. Në regjimin e brendshëm ndodheshin 4 bokse ajrimi (çdo sektorë më vehte) dhe një fushë futbollit, ku lejoheshin të zhvilloheshin aktivitete sportive me grupe të vogla.

Në IEVP Rrogozhinë ishin funksionale 3 palestra, të ndara nga një për secilin sektor. Ato ishin të pajisura me vegla force dhe qëndronin hapur sipas orarit të miratuar nga drejtuesi i këtij institucioni. Palestrat janë një mundësi e mirë për të dënuarit, për të lehtësuar stresin dhe kaluar kohën e lirë.

Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se, sektori i çështjeve shoqërore kishte të miratuara planet për zhvillimin e aktiviteteve sportive me të dënuarit, si dhe programet individuale të këshillimit të ndarë më vehte për moshat 18-21 vjeç dhe për grup moshat e tjera.

Në IEVP Rrogozhinë funksiononte dhe shkolla 9-vjeçare dhe mësimi zhvillohej nga një staf prej 4 mësuesish të shkollës 9-vjeçare “Xhorxh Soros”, Rrogozhinë të miratuar nga drejtorja e Zyrës Vendore Arsimore në Kavajë.

---

<sup>13</sup>Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika 25.1 dhe 25.2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>.

## Shërbimi shëndetësor

Organika e stafit shëndetësor të IEVP Rrogozhinë përbëhet nga 9 punonjës, nga të cilët 2 mjekë (të përgjithshëm/specialist), 1 stomatolog, 1 farmacist dhe 5 infermierë, të gjithë me kohë të plotë. Mjeku i institucionit, ishte i punësuar me kontratë me kohë të pjesëshme 4 orë në ditë, por dhe paraqitej sa herë kishin nevojë të dënuarit. Ndërsa njëri nga pozicionet e mjekut ishte vakant, për shkak të mungesës të mjekëve. Për nevoja të mjekëve specialist, të dënuarit me rekomandim të mjekut të institucionit, dërgoheshin për vizitë mjekësore në Spitalin Rajonal të Kavajës.

Nga intervistat me të dënuarit nuk u konstatuan ankesa përse i përket ofrimit të shërbimit shëndetësor nga institucioni, por kishin ankesa për mungesën e mjekëve specialistë në spitalin e Kavajës. Në mungesë të mjekëve specialistë, të dënuarit e sëmurë dërgoheshin, sipas planit të miratuar nga DPB, në Spitalin e Burgjeve ose në QSUT “Nënë Tereza”.

Avokati i Popullit sjell në vëmendjen tuaj qëndrimet e KPT-së (CPT-së) në lidhje me vonesën e qasjes të të burgosurve te mjeku specialist, duke rekomanduar se: *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre” dhe se, “shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”,* si dhe Rregulloren Evropiane të Burgjeve ku përcaktohet se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”<sup>14</sup>.*

Ambientet e sektorit shëndetësor të institucionit, ndodhen në katin e dytë të ndërtesës në hyrje të regjimit të brendshëm, ku përfshihen dhoma e vizitave të mjekut, dhoma e infermierëve, si dhe dhoma për shtrimin e dënuarve të sëmurë, e kompletuar me 6 krevatë. Ky ambient ishte rikonstruktuar nga “Shoqata Kristiane e të Burgosurve të Shqipërisë”, financuar nga Mbretëria e Hollandës.

Dhoma e mjekut dhe dhoma e infermierëve, ishin të kompletuara me orenditë e nevojshme për kryerjen e vizitave mjekësore si krevati, tavolina e punës, karrige dhe rafti për mbajtjen e kartelave mjekësore të të dënuarve. Dhoma e mjekut stomatolog ishte e kompletuar me pajisjet e nevojshme dhe kryente ndërhyrje për mbushjen e dhëmbëve dhe shërbimet e urgjencës, ndërsa ndërhyrjet kirurgjikale kryheshin në klinikat private, sipas rekomandimit të stomatologut dhe shpenzime që mbuloheshin nga vetë të dënuarit.

---

<sup>14</sup> Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

Mjeku kishte në administrim regjistrat e vizitave mjeksore me të dënuarit, si dhe regjistrin për evidentimin e rasteve të dhunës dhe përdorimit të mjeteve shtrënguese të forcës me pacientët që paraqisnin probleme të theksuara të shëndetit mendor.

Gjendja shëndetësore e të dënuarve paraqitej përgjithësisht e mirë, ndërkohë të sëmurë kronikë ishin evidentuar 16 persona me probleme të shëndetit mendor dhe 12 persona ish-përdorues të substancave narkotike që trajtohen me “metadon” nga shoqata “Aksion plus”, Tiranë. Këta persona trajtohen çdo ditë me medikamente, por ishin në kontroll të përditshëm nga mjeku i institucionit dhe stafit të infermierëve që krynin shërbim 24 orësh. Avokati i Popullit vlerëson se, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve duhet të punësojnë mjek psikiatër, që të bëjnë vizita periodike për këta të sëmurë një herë në çdo dy javë.

Shpërndarja e medikamente për të dënuarit e sëmurë, kryhej nga farmacisti dhe infermierët sipas turneve, në bazë të rekomandimit të mjekut të institucionit. Fondi i ilaçeve të institucionit sigurohej në tre mënyra, për të sëmurët kronikë nga depo farmaceutike sipas kontratës të lidhur me FSDKSH-së dhe IEVP-në, furnizimit me medikamente nga sektori i shëndetësisë në DPB, si dhe për nevoja emergjente nëpërmjet blerjeve të drejtëpërdrejta nga fondet në dispozicion të IEVP-së.

Dokumentacioni që mbahej nga sektori shëndetësor ishte i plotë dhe i plotësuar në rregull. Në dhomën e mjekut dhe atë të infermierëve ndodheshin disa regjistra, si regjistri i vizitave mjekësore, regjistri për të sëmurët kronikë, regjistri i shpërndarjes së medikamenteve, regjistri i ilaçeve që siguroheshin nga familja, si dhe regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve. Regjistrat ishin të sekretuar e të plotësuar në rregull sipas rubrikave. Kartelat mjekësore të të burgosurve ishin gjithashtu të plotësuar dhe të përditësuara nga mjekët e institucionit dhe të mbyllura në dollap të veçantë me çelës.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:  
b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”.

### **REKOMANDOJMË:**



1. Të merren masat e nevojshme, për miratimin sa më parë nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, të Rregullores së Brendshme të I EVP Rrogozhinë, pasi kjo është një gjetje e përsëritur edhe në I EVP e tjera.
2. Të merren masat për plotësimin e menjëhershëm të vendeve vakante, sipas organikës të I EVP Rrogozhinë, miratuar me Urdhërin nr.174, datë 19.10.2022 të Kryeministrit të Shqipërisë.
3. Marrjen e masave të menjëhershme, për planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve social-kulturore e sportive me pjesëmarrjen e të dënuarve, që shërbejnë rehabilitimit dhe ri-integrimit të të dënuarve.
4. Marrjen e masave të menjëhershme, për zëvendësimin e posterave me të drejtat e të burgosurve me postera të rinj, si dhe vendosjen e tyre në vende të aksesueshme nga të dënuarit.
5. Të merren masa të menjëhershme, në bashkëpunim me kompaninë që ofron shërbimin telefonik në burgje, për mundësimin e komunikimit të të dënuarve me institucionin e Avokatit të Popullit, në çdo kohë dhe pa pagesa shtesë.
6. Marrjen e masave të nevojshme, për kryerjen e investimeve me qëllim riparimin e instalimeve elektrike dhe heqjen e kabllave elektrike që varen në muret e dhomave të banimit, pasi përbëjnë rrezik për sigurinë e jetës së të dënuarve.
7. Të merren masat e nevojshme, për kryerjen e investimeve në ambientet e banimit të të dënuarve, me qëllim eliminimin e lagështirës.
8. Marrjen e masave të nevojshme, për shtimin e numrit të kamerave të sigurisë në ambientet e brendshme të institucionit, që nuk mbulojnë nga kamerat ekzistuese të sigurisë, me qëllim parandalimin e veprimeve të kundraligjshme nga punonjësit e policisë ndaj të dënuarve.
9. Marrjen e masave të menjëhershme nga DPB-ja për transferimin nga I EVP Rrogozhinë e personave të dënuar që ndodhen në dhomat e observimit për mospërshtatje në këtë institucion, në një I EVP tjetër.
10. Marrjen e masave të nevojshme nga I EVP Rrogozhinë, në bashkëpunim me ujësjellësin e qytetit Rrogozhinë, me qëllim shtimin e orareve për furnizimin me ujë të ambienteve në regjimin e brendshëm, për larjen e trupit nga të dënuarit dhe mbajtjen e pastërtisë e të higjienës së ambienteve të përbashkëta.
11. Marrjen e masave të nevojshme, për kryerjen periodike të analizës së ujit për të garantuar furnizimin me ujë të pijshëm të të dënuarve.
12. Të merren masa të menjëherëshme për ruajtjen dhe etiketimin e kampioneve të ushqimit, sipas rregullores dhe protokolleve për sigurinë ushqimore.
13. Të merren masat e nevojshme, për kompletimin e dhomave të banimit të të dënuarve, me dollapë për ruajtjen e ushqimeve dhe të sendeve personale.

14. Të merren masat e menjëhershme, nga DPB në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, për miratimin e udhëzimit dhe lejimin e aplikimit të të dënuarve për leje shpërblyese.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONERI**

**Ahmet PRENÇI**